



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-030/01-185223/22, më 03. 08. 2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

1. MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, plotësim - ndryshimi nënkupton themelimin e Zyrës Koordinuese për Diasporën, e cila do të funksionoj në kuadër të Kabinetit të Kryetarit.
3. Sipas pikës 2 të këtij Vendimi, Zyra Koordinuese për Diasporën, përbëhet nga Udhëheqësi i Zyrës, cili i raporton Kryetarit të Kryeqytetit dhe një (1) zyrtar administrativ, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës, janë:
 - 3.1. Organizimi i ngjarjeve që synojnë promovimin e partneriteteve të reja biznesore, rritjen e eksporteve dhe tërheqjen e investimeve të huaja nga diaspora në Komunën e Prishtinës. I përgjigjet pyetjeve të diasporës lidhur me zhvillimin e biznesit dhe investimeve të tyre në komunën e Prishtinës;
 - 3.2. Ofrimi i këshillave në lehtësim të procedurave administrative dhe shërbimeve të dhëna nga Komuna, veçanërisht gjatë fluksit të madh të vizitorëve nga diaspora gjatë sezonit të pushimeve;
 - 3.3. Zhvillimi dhe shpërndarja periodike e përmbajtjeve të rëndësishme informative me rëndësi për diasporën lidhur me zhvillimet në komunë, me theks të veçantë në çështjet ekonomike por edhe kulturore;

3.4. Zhvillimi i një mekanizmi për të mundësuar transferimin e njohurive dhe aftësive nga profesionistët e diasporës në departamente të ndryshme komunale (mund të ketë aktivitete të ndryshme në këtë drejtim si trajnime, mentorime, seminare, vlerësime të projekteve, lehtësim i lidhjeve me institucionet, organizatat përkatëse jashtë vendit);

3.5. Vendos në shfrytëzim marrëdhëniet dhe ndikimin e pjesëtarëve të diasporës në vendet e tyre rezidente, për të promovuar turizmin, produktet vendore dhe sektorë të tjerë ekonomik me interes për Komunën. Pjesëtarët e diasporës mund ta luajnë lehtësisht rolin e ambasadorit të Komunave në fusha të ndryshme në vendet rezidente;

3.6. Krijimi i data bazës përfshirëse të pjesëtarëve të Diasporës nga Komuna e Prishtinës;

3.7. Inicimi i krijimit të platformave filantropike në Diasporë, me qëllim të ofrimit të mbështetjes financiare në kauzat me interes të Kryeqytetit.

4. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

**Qendrës për shërbim me qytetarë;
Në dosje.**

**KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama**

